



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH**

---

2021:128569

Numri i lëndës:

Datë: 13.07.2022

Numri i dokumentit: 03222890

**PPP.nr.101/21**

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil**, gjyqtarja Sabaheta Kurteshi me bashkëpunëtorin profesional Gjelbrim Gërdellaj, në çështjen juridike të përmbarrimit sipas propozimit për përmbarrim të kreditorit A. N., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Av. B. K. nga Prizreni, Rruga “D. R.” nr..., kundër debitorit Komuna e Dragashit – Drejtoria Komunale e Arsimit Dragash, të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës Sh. Sh. nga Dragashi, për pagesën e borxhit në shumën prej 624.00 (gjashtëqind e njëzetë e katër euro) €, në emër të shujtave ditore dhe i lejuar me Urdhërin për përmbarrim, P.nr.3358/2020 të dt. 03.12.2020 të Përmbarruesit Privat E. H. nga Prizreni, duke vendosur sipas prapësimit të ushtruar nga debitori i përmbarrimit të dt. 17.12.2020, jashtë seance me dt. 13.07.2022, mori këtë:

## **A K T V E N D I M**

**I. REFUZOHET** tërësisht si i pa bazuar prapësimi i debitorit të përmbarrimit, Komuna e Dragashit – Drejtoria Komunale e Arsimit në Dragash, paraqitur dhe përfaqësuar nga Kryetari i Komunës Sh. Sh. nga Dragashi, i ushtruar kundër Urdhërit për përmbarrim, P.nr.3358/20 të dt. 03.12.2020 të Përmbarruesit privat, E. H. nga Prizreni dhe i njëjti Urdhër për përmbarrim, **Mbetet tërësisht në fuqi.**

**II.** Me shpenzimet e procedurës ngarkohet debitori.

## **A r s y e t i m**

Përmbarruesi privat në territorin e Gjykatës Themelore në Prizren, të cilin nuk e ndalon të veproj jashtë territorit të tij ku është i licencuar konform nenit 323 par. 4 të LPP-së, duke vepruar sipas propozimit për përmbarrim të kreditorit ka nxjerrë Urdhërin P.nr.3358/20 të dt. 03.12.2020, me të cilin ka caktuar përmbarrimin në bazë të vendimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqeniës Sociale, Inspektorit të Punës, Nr.878/2019 i dt. 01.10.2019, i cili përbën dokument përmbarrues konform dispozitave të nenit 21, 22 dhe 24 paragrafi 3 të LPP-së.

Kundër urdhërit për caktimin dhe lejimin e përbarimit, brenda afatit ligjor të përcaktuar debitori ka paraqitur prapësim duke e kundërshtuar në tërësi urdhërin duke propozuar që i njëjti të shfuqizohet. Ka theksuar ndër të tjera se Vendimi i Inspektorit të Punës, në këtë rast nuk është i mjaftueshëm për miratimin e vendimit por nevojitet një analizë më e detajuar e Marrëveshjes Kolektive për Arsimin në Kosovë, gjithashtu duhet analizuar detyrat të cilat i ka Sindikata e arsimit si organizatë kryesore për mbrojtjen e të drejtave të punëtoreve, e këtë e paraparë me nenin 46 par. 1 të Kontratës Kolektive rreth instruksioneve dhe udhëzimeve të MASHT-it në lidhje me buxhetimin dhe se Komuna e Dragashit nuk do të ketë buxhet për pagesën e këtyre shujtave.

Kreditori përmes të autorizuarit të tij në përgjigje në prapësim ka theksuar se në procedurën permbarimore shikohet vetëm a është vendimi i plotëfuqishëm dhe i permbarueshëm, nëse pala debitore konsideron që Inspektoriati është jo kompetent për ta nxjerrë një vendim të tillë, atëherë të njëjtët duhet të hapin konflikt administrative. Gjykata permbarimore nuk mund të lëshohet në atë se a është kompetent inspektoriati për të nxjerrë një vendim të tillë apo jo. Kjo parashihet edhe në nenin 22 par. 1 pika 1.2 të LPP-së dhe përben bazën juridike për përcaktimin e permbarimit sipas nenit 21 duke edhe i plotësuar edhe kushtet nga neni 24 par. 3 dhe 27 par. të po këtij ligji. Ndersa sa i përket çështjes se debitori nuk ka mundur ti transferoj mjetet në llogari të kreditorit, nuk qëndron pasi që të gjitha llogaritë e kreditorit i posedon debitorja, meqenëse është punëdhënëse e debitorit dhe të gjitha pagat i ekzekuton në llogaritë e tij.

Andaj ka propozuar që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pa themelt pasi që prapësimi i debitorit nuk është i mbështetur në asnjë nga kushtet e parapara me nenin 71 të LPP-së.

Gjithashtu kjo gjykatë, me qëllim të kuptimit të plotë të validitetit të prapësimit të palës debitore e kjo në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së, nuk ka caktuar seancë gjyqësore, ngase të dhenat e parashtruara në propozimin për permbarim si dhe dëshmime të bashkangjitura prapësimit nga ana e debitorit, janë të mjaftueshme për të vendosur rreth kësaj çështje juridike të permbarimit.

Gjykata, pas shqyrtimit të prapësimit të debitorit dhe përgjigjes në prapësim si dhe shikimit dhe vlerësimit të shkresave tjera të lëndës, ka gjetur se Urdhëri për permbarim është marrë dhe caktuar në bazë të titullit permbarues konform nenit 21 dhe 22.1 nënpar. 1.2 të LPP-së dhe se prapësimi i debitorit i parashtruar kundër Urdhërit për permbarim është i pa bazuar, për faktin se nuk përmbushen asnjë nga shkaqet e parapara në nenin 71 të LPP-së, sepse debitori nuk ka ofruar prova në mbështetje të pretendimeve të ti, siç është përcaktuar me nenin 69 par. 4 të LPP-së e që për rrjedhojë nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet për anulimin apo shfuqizimin e urdhërit për caktimin e përbarimit. Ndërsa deklaratimet tjera të debitorit nga prapësimi e veçanërisht potencimeve se Komuna e Dragashit nuk do të ketë buxhet për pagesën e këtyre shujtave, gjykata vlerëson se ky pretendim i debitorit është i parëndësishëm në këtë rast, pasi që gjykata nuk ka tagër (të drejtë) në procedurën permbarimore të lëshohet në ligjshmërinë dhe rregullësinë e dokumentit permbarues dhe se për çdo pakënaqësi tjetër do të duhej të adresohet tek organet kompetente, kurse gjykata me rastin e shqyrtimit të kësaj çështje permbarimore është mbështetur në dokumentin e besueshëm – vendimin e plotëfuqishëm dhe të ekzekutueshëm si dokument permbarues i përcaktuar me nenin 22 par.1 pika 1.2 të LPP-së.

Në bazë të nenit 144 par. 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative thuhet se: *“Një akt bëhet i ekzekutueshëm me njoftimin e palës me aktin, kur sipas ligjit ankesa nuk ka efekt pezullues”*.

Sa i përket vendimit mbi shpenzimet e procedurës së permbarimit kur u vendos që debitori të ngarkohet me shpenzimet e procedurës, u vendos në kuptim të nenit 13 të LPP-së lidhur me nenin 452 të LPK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të nenit 71 të LPP-së, vlerësojë se prapësimi është i pa bazuar dhe të njëjtin e refuzoj në tërësi, bazuar në këtë dispozit si dhe në dispozitat e nenit 69 par. 4 dhe nenit 73 të Ligjit për Procedurën Përmbaremore (Nr.04/L-139), vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL  
2021:128569, 13.07.2022**

**G j y q t a r j a,**

---

**Sabaheta Kurteshi**

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, përmes kësaj gjykate.